



BASHKIA  
TIRANË

## DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

**Drejtuar:** Shoqeria “Erzeni/Sh” sh.p.k  
Adresa: Lagja Bahçallek, Rruga nacionale Shkoder-Tirane, Nr.pasurie 179/910,  
Zona kadastrale 8591, Shkodër

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e Prokurimit:** ”Kërkesë për Propozim” “Blerje dollape për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është ”Blerje dollape për Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme”, Tirane.

**Fondi Limit:** 1.783.333 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

**Burimi i financimit:** Fond i vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë me anë të VKB Nr.84, datë 29.12.2016 për ”Miratimin e programit buxhetor afatmesem 2017-2019 dhe detajime të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2017”.

Publikim të mepareshme : Buletini i Njotimeve Nr.26, date 03 Korrik 2017

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikiht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit me vlerat perkatese te ofruara:

1- Operatori ekonomik “Erald” sh.p.k **NIPT J74517205P**

Vlera e ofertës = **1.560.000** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë) lekë pa TVSH

2- Operatori ekonomik “Lel” sh.p.k **NIPT K 81917006T**

Vlera e ofertës = **3.165.600** (tremilion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

3- Operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k **NIPT K42003004T**

Vlera e ofertës = **1.688.000** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetëmijë) lekë pa TVSH.

4- Operatori ekonomik "Mega-Plast-2L" shpk NIPT L56615701K

Vlera e ofertës = **1.692.000** (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë) lekë pa TVSH.

4 - Operatori ekonomik " Bolt " sh.p.k NIPT K91517011V

Vlera e ofertës = **1.740.000** (një milion e shtatëqind e dyzetmijë) lekë pa TVSH.

5 - Operatori ekonomik " Erzeni/Sh " sh.p.k NIPT J66902027T

Vlera e ofertës = **1.750.000** (një milion e shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

### **1. Operatori Ekonomik "Erald" shpk**

1. Operatori ekonomik "Erald" shpk në plotësim të pikës 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 1 "Furnizime të mëparshme të ngjashme..." ka paraqitur një kontratë me objekt: "Blerje pajisje mobilerie për shkollat e sistemit arsimor parauniversitar". Kjo kontratë është në bashkëpunim midis shoqërisë "Erald/K" shpk dhe shoqërisë "Igli-Sand" shpk. Në kontratë si edhe në dokumentacionin shoqëruar të kësaj kontrate si (vertetim realizimi, njoftim fituesi etj ) nuk është përcaktuar se sa është ndarja e përqindjes së furnizimit që ka realizuar secili nga operatorët ekonomikë "Erald" shpk dhe "Igli-Sand" shpk , në mënyrë që të vlerësohet dhe gjykohet nëse operatori ekonomik "Erald" shpk plotëson vlerën e objektit që do të prokurohet në bazë të përqindjes së partneritetit. Në mbështetje të gërmës "b", pika 1 e nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikës 4, Neni 27 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", të cilat parashikojnë kualifikimin për përvojën e mëparshme të kandidatëve ofertues, shoqëria "Erald" sh.p.k, nuk ka provuar nepermjet dokumentacionit të paraqitur se zoteron përvojën e duhur për realizimin me sukses të kontratës.
2. Operatori ekonomik "Erald" shpk nuk ka paraqitur deklaratë personale nga administratori i shoqërisë me ane të se ciles merr persiper të kryeje shërbimin e transportit si dhe vendosjen e mallrave në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke mos plotësuar Kriteret e Vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 4.

### **2. Operatori ekonomik "Murati D" shpk**

**Në kriteret të vecanta për kualifikim, "Kapaciteti Teknik" është kërkuar sa më poshte:**

Te paraqitet nje mjet transporti me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton secili mjet. Mjetet e transportit mund te jene në pronësi ose me qera...

Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik “Murati D” shpk ka paraqitur mjetin me targa AA352BS me kontrate qeraje Nr.465 Rep, Nr.165Kol, date 07.03.2017.

Ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne komisioni i vleresimit te ofertave ka bere perlllogaritjen e kapacitetit mbajtes te mjetit sa me poshte vijon:

Ne lejen e qarkullimit te mjetit referuar Nr.23 pesha 7.49 ton perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar Nr.24 te lejes së qarkullimit të mjetit pesha 5.21 ton perfaqeson peshen e vetë mjetit të gatshem për lëvizje.

Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

**“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshen e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”**

Ne vijimesi te këtij gjykimi komisioni i vleresimit te ofertave vlerëson se kapaciteti mbajtës i mjetit të mësipërm është 2.28 ton pra nuk është mbi 3.5 Ton sic është kërkuar në dokumentat e tenderit, Kriteret e Vecanta për Kualifikim, kapaciteti teknik.

Pra sa me sipër ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik nuk plotesohet kriteri I percaktuar nga autoriteti kontraktor qe mjeti te kete kapacitet mbajtes mbi 3.5 Ton .

**3. Operatori ekonomik “Mega-Plast-2L” shpk**

Ne kriteret te vecanta per kualifikim, “Kapaciteti Teknik” është kërkuar sa me poshte:

Te paraqitet nje mjet transporti me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton secili mjet. Mjetet e transportit mund te jene në pronësi ose me qera

Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik “Mega-Plast- 2L” shpk ka paraqitur mjetin me targa AA977 JV.

Ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne komisioni i vleresimit te ofertave ka bere perlllogaritjen e kapacitetit mbajtes te mjetit sa me poshte vijon:

Ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 pesha 3.2 ton perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar Nr.24 te lejes së qarkullimit të mjetit pesha 2.16 ton perfaqeson peshen e vetë mjetit të gatshem për lëvizje.

Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

**“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshen e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”**

Ne vijimesi te këtij gjykimi komisioni i vleresimit te ofertave perllorarit kapacitetin mbajtës te mjetit të mësipërm perkatesisht 1.04 ton pra nuk është mbi 3.5 Ton sic është kërkuar në dokumentat e tenderit, Kriteret e Vecanta për Kualifikim, kapaciteti teknik.Gjithashtu per mjetin me targë AA977JV nuk jane paraqitur dhe taksat vjetore te mjetit.

Gjithashtu ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik “Mega-Plast-2L” ka paraqitur dhe mjetin me targë AA055 MV. Edhe per kete mjet referuar sa me siper cituar kapaciteti mbajtes i perlloratur referuar lejes se qarkullimit te mjetit është 1.3 Ton pra nuk ploteson kriterin e percaktuar nga Autoriteti Kontraktor ku kërkohet specifikesht që operatori ekonomik te paraqese mjet me kapacitet mbajtes mbi 3.5 Ton.

Pra sa me siper ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik nuk plotesohet kerkesa per paraqitjen e nje mjeti me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton.

#### **4. Operatori ekonomik “Bolt” shpk**

Ne **kriteret te vecanta per kualifikim, “Kapaciteti Teknik” është kërkuar sa me poshte:**

Te paraqitet nje mjet transporti me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton secili mjet. Mjetet e transportit mund te jene në pronësi ose me qera

Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik “Bolt” shpk ka paraqitur mjetin me targë AA627 HD.

Ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne komisioni i vleresimit te ofertave ka bere perlloraritjen e kapacitetit mbajtes te mjetit sa me poshte vijon:

Ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 pesha 3.5 ton perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar Nr.24 te lejes së qarkullimit të mjetit pesha 2.28 ton perfaqeson peshen e vetë mjetit të gatshem për lëvizje.

Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

**“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshen e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”**

Ne vijimesi te këtij gjykimi kvo vlerëson se kapaciteti mbajtës i mjetit të mësipërm është 1.22 ton pra nuk është mbi 3.5 Ton sic është kërkuar në dokumentat e tenderit, Kriteret e Vecanta për Kualifikim, kapaciteti teknik.

Gjithashtu ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik “Bolt” shpk ka paraqitur dhe mjetin me targë AA874KA. Edhe per kete mjet referuar sa me siper cituar nga perlloraritja e bere referuar lejes se qarkullimit kapaciteti mbajtes është 0.66 Ton pra nuk ploteson kriterin e percaktuar nga Autoriteti Kontraktor ku kërkohet specifikesht që operatori ekonomik te paraqese mjet me kapacitet mbajtes mbi 3.5 Ton.

Pra sa me siper ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik nuk plotesohet kerkesa per paraqitjen e nje mjeti me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“Erzeni/Sh”sh.p.k** me adresë kryesore: Adresa : Lagja Bahçallek, Rruga nacionale Shkoder-Tirane, Nr.Pasurie 179/910, Zona kadastrale 8591, Shkoder, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme pa TVSH= **1.750.000 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë** është identifikuar si *oferte e sukseshme*.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tirane , sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit te këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë me datë 11.07.2017

Gjate afatit Ligjor per pritjen e ankesave te shoqerive pjesmarrese ne tender ne mbeshtetje te Nenit 63 te Ligjit 9643 date 20.11.2006 “ Per prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X,Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” per **“Blerje dollape për Drejtorine e Konvikteve të Shkollave të Mesme”** nuk është paraqitur asnje ankese

Me respekt,

